

# ***Hulumtimi i Opinionit Publik – Teknikat hulumtuese për marrjen e të dhënave***

*Lulzim Pllana*

## ***Përmbledhje***

Në shoqëritë moderne hulumtimi i opinionit respektivisht mbledhja e informatave, çfarëdo qofshin ato, janë më se të nevojshme për zhvillimin e mëtutjeshëm si dhe definimin dhe matjen e shumë çështjeve të ndryshme në shoqëri si: të zhvillimit social-demografik, zgjedhjeve politike, sjelljeve të konsumatorëve, turizmit etj.

Me rëndësi të veçantë është edhe përdorimi i metodologjisë, metodave apo teknikave të përshtatshme për marrjen e të dhënave të nevojshme. Në këtë punim do të jepet një pasqyrë e metodave të hulumtimit të opinionit, me një përshkrim të shkurtër rreth aplikueshmërisë së tyre në Kosovë.

***Fjalët kyç:*** Metodatat, hulumtimi, hulumtimi i opinionit në Kosovë, Intervistat, pyetësi, hulumtime kuantitative, hulumtime kualitative, Face-to-Face, CATI, CAWI.